

Xhemile Selmani, MA¹

UDC:
342.7:342.565.2.037(497.7)

**STRATEGJIA SHTETËRORE E SIGURISË NË MBROJTJEN E
LIRISË SË SHPREHJES, SI NJË NGA TË DREJTAT
INDIVIDUALE**

**ДРЖАВНАТА БЕЗБЕДНОСНА СТРАТЕГИЈА ЗА ЗАШТИТА
НА СЛОБОДАТА НА ИЗРАЗУВАЊЕ КАКО ЕДНО ОД
ИНИДИВИДУАЛНИТЕ ПРАВА**

**STATE SECURITY STRATEGY IN PROTECTION OF THE
FREEDOM OF EXPRESSION ASA ONE OF THE INDIVIDUAL
RIGHTS**

Abstract

The reaction that the individual has to the living conditions that he or society builds for, on a great extent depends on the level of fear or security that he will have to live. The freedom to analyze such a thing exists in every individual, but the way it is measured is very personal.²

Protection of the rights of the individual in freedom of expression and security constitutes aspirations to protect the human dignity of all human beings; these fundamental rights represent the essence of the concept of human rights in the Republic of Macedonia. This aspiration puts the human being at the center of interest and is based on the common universal value system dedicated to the right to life, as an intangible right, and provides a framework for building a human rights system, protected by internationally accepted norms and standards. The Republic of Macedonia's strategy aims at EU membership. However,

¹ Master of Political Science and Security at the same time also engaged in the teaching process.

² Bashkim Selmani, PhD "Criminology with Penology" - University text, pg.39-49 College "FAMA" - Prishtina, 2013

such aspiration can be accelerated, if it meets the necessary conditions, where the protection of the individual's right to freedom of expression and human security is exactly part of it. In this regard, the main reason for hope should not be related to the nature of these challenges, but with the speed and dynamics of practical response and that of constitutional and legal legislation, that these rights have to be honestly respected, to feel its citizens these rights, and not to be brought laws for Europe and European standards. The citizens of the Republic of Macedonia demand and expect that the competent state institutions always and increasingly recognize their needs and that they will use this as a basis for the development of their service and to increase the efficiency of the fight against violations of the human being, which will result in a more functional and democratic state apparatus for all citizens, based on freedom and equality of individuals. From researches and so far surveys it is concluded that politics realizes its institutional strength through the state, because the political struggle between the parties, first and foremost, is state-oriented, as their ultimate goal. The state represents the fundamental political interest of any political party, because each party has the right to organize legitimate binding measures.

Keywords: Protection freedoms, rights, protection of individual rights, freedom of expression, security, aspiration, human dignity, fundamental rights concept for human rights, objective, efficiency, expectation, fundamental interest, political parties, legality, etc.

1. Kuptimi lirisë së shprehjes dhe të drejtat individuale

Liria e shprehjes si e drejtë, në fakt, buron nga ideja e barazisë të drejtave dhe lirisë të të gjithë njerëzve. Kjo e drejtë ka një historik të gjatë pesëshekullor filozofik-etik dhe juridiko-politik. Historia e kësaj lirie korrespondon me historinë e demokracisë në Evropë dhe Amerikën Veriore dhe luftën për lirinë e shtypit, përkatësisht lirinë e mediave. Sa i përket shekullit të XX-të, afirmimi dhe rëndësia dramatike e lirisë së shprehjes veçanërisht është potencuar pas traumave të mëdha shoqërore në kohën midis dy luftërave botërore, Holokaustit, Luftës e Ftohtë, rënies së Murit të Berlinit. Në një numër të madh të punimeve shkencore, kushtuar kësaj të drejte, citohet mendimi i Xhon Stjuart Mil, i cili thotë: “Liria e shprehjes na mbron nga pushteti i korruptuar dhe tirania. Kjo liri është një nga garancitë themelore për shoqëri të hapur dhe pluraliste. Pas rënies së Murit të Berlinit pritjet kryesore ishin të

sigurohej liria e shprehjes dhe informimit, sigurimi i konkurrencës, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut, gëzimi i të drejtave të njeriut si dhe individualiteti. Por, liria e shprehjes, si e drejtë, u radikalizua në të gjitha aspektet e saj, veçanërisht në vendet e Evropës Juglindore. Fjalimet e drejtpërdrejta politike, demonstratat, pamfletet, intervistat e lira, artikujt analitik i okupuan mediat, ndërsa komunikimi i lirë ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve duhej të vendosej si parim themelor i egalitetit demokratik.³

2. Njohja e të drejtave të njeriut

Një numër i madh i qytetarëve nuk janë të njohur mirë me të drejtat dhe detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore, që parasheh legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, prandaj qytetarëve duhet t'u ofrohet më tepër informacione dhe strategji të veçanta për njohjen e të drejtave themelore të njeriut si dhe ato të drejta që kanë karakter universal për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Disa lëndë shkencore juridike duhet të jenë përfshirë edhe nëpër Shkollat e Mesme me qëllim që të rinjtë të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre juridike në kohë dhe momente të caktuara, sepse mosnjohja e ligjeve nënkupton edhe përkufizimin e të drejtave të njeriut. Duhet të krijohen Institute të veçanta për të përcjellë situatën nga afër për sa i përket shkeljes së të drejtave të njeriut në këndvështrimin e lirisë së mendimit të lirë dhe shprehjes. Një grup i qytetarëve të anketuar; rreth 28 ose 14% u drejtohem institucioneve shtetërore në rast se nuk mund t'i zgjidhin problemet e tyre në lëmin e këtyre të drejtave që e kemi objekt studimi, pikërisht edhe kjo kategori e qytetarëve bën veprim të matur, sepse u besojnë institucioneve shtetërore se ata janë të ftuara në mënyrë kushtetuese dhe ligjore për të mbrojtur dhe ndihmuar qytetarët nga të gjitha kufizimet që mund t'u ndodhin qoftë nga ana e institucioneve ose nga vet qytetarët në relacionet e tyre, qofshin juridike ose penale. Në teorinë juridike liria e shprehjes trajtohet edhe si kompilacion i më shumë të drejtave (siç është e drejta e lirisë së mendimit, e ndërgjegjës dhe besimit, e drejta e shprehjes publike të mendimit, e drejta e pjesëmarrjes në jetën kulturore, e drejta e privatësisë) prandaj dhe paraqiten paqartësi të caktuara në koncept. Liria e shprehjes trajtohet edhe si e drejtë e dyfishtë. Përkatësisht, e drejta e parë, të dërgohen,

³ Bashkim Dr. Selmani, "Roli i të drejtave të njeriut dhe pozita e qytetarëve sa ata i ndjejnë dhe i gëzojnë këta të drejta që i garanton legjislacioni i Maqedonisë", f. 3-4, Revista shkencore "CENTRUM" nr. 3, Shkup, 2015.

transmetohen ose shprehen mendimet dhe idetë e çdo lloji (shprehje politike, artistike, komerciale) dhe e dyta, e drejta të kërkohen dhe të merren informata në çdo formë (gojarisht, me shkrim, përmes formave të artit, mediave, përfshirë edhe teknologjitë e reja). E vendosur në këtë mënyrë, kjo e drejtë është pjesë integrale e të drejtës për të komunikuar. E drejta e përkufizuar në këtë mënyrë duhet të jetë me interes, para së gjithash, për krijuesit e politikave, për ata të cilët i formulojnë politikat, për çështje juridike, ekonomike dhe politike.

3. Theksi mbi krijimin e politikave të mediave

Në këtë domen, theksi vihet edhe mbi krijimin e politikave të mediave, kështu për shembull, vihet re një vëllim i madh i aktiviteteve në këtë drejtim nga ana e Këshillit të Evropës i cili arriti, në masë të konsiderueshme, të rregullojë një pjesë të parimeve bazë, sa i përket kësaj çështje, siç është liria e shprehjes dhe privatësia. Me këtë, Këshilli i Evropës si dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut luajtën rol të ngjashëm me rolin e gjykatave kushtetuese të disa juridiksioneve nacionale. Sa i përket domethënies terminologjike dhe juridike të lirisë së shprehjes, për ne është e rëndësishme Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Fillimisht, kjo Konventë u trajtua si shprehje e identitetit të demokracive liberale euro-perëndimore dhe si mjet me të cilin shtetet mund të mbroheshin nga kërcënimet e brendshme nga autoritarizmi, duke paraqitur ankesa drejtuar Tribunalit Ndërkombëtar Gjyqësor *Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut*.⁴ Megjithatë, nga fillimi i shekullit XXI, roli kryesor i Konventës është fokusimi në artikullimin e një “modeli abstrakt kushtetues” për tërë kontinentin, veçanërisht duke i përfshirë shtetet e sapo-pranuara postkomuniste, si dhe duke siguruar mjete për promovimin e konvergencës në themelet e strukturës dhe funksionit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes në Evropë”⁵

4. Rëndësia e marrëdhënieve ndëretnike

Ndryshimet që mund të bëhen në lidhje me politikën parandaluese dhe pikëpamjet krahasuese mes legjislacioneve përkatëse ndërkombëtare në mbrojtje të vlerave dhe dinjitetit njerëzor dhe

⁴ Shih: Rregullimi i mediave, studim komparativ, Dejvid Goldbert, Toni Proser dhe Stefan Berhulst, Ars Lamina, Shkup, 1998, f. 155-184;

⁵ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Stiven Grir, “Prosvetno delo”, Shkup, f. 1-15.

individual. Çdo herë duhet të pranohet frustrimi i popullatës për shkak të procesit të gjatë të tranzicionit dhe mungesës së rezultateve të dukshme. Edhe më tej ekzistojnë deficite në ndërtimin e mendimit publik dhe realizimin e lirisë së mediave në Republikën e Maqedonisë dhe duhet me tepër përkushtim në këtë përforsimin e mendimit publik. Rëndësia e marrëdhënieve ndëretnike duhet të jete me prioritet me të lartë në agjendat politike, posaçërisht në R. e Maqedonisë si vend shumë-etnike. Bashkëpunimi rajonal në nivel të përgjithshëm dhe veçanërisht në çështjet e sigurisë duhet të përforsohet edhe më tej. Duhet të merren parasysh llojet e ndryshme të bashkëpunimit rajonal në pronësi Demokratia dhe siguria e njeriut sepse është një nga prioritet elementare të demokracisë së mirëfilltë. Por, synimi kryesor i këtij studimi shkencor ka pasur qëllimin që t'i përkushtoj një rëndësi të veçantë të drejtave të njeriut që realisht është e prekur nga një sërë rrethanash jo aq të studiuar edhe në aspektin shkencor. Liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara dhe e njëjta kalon në dukuri e cila është e kundërta e plotë e saj. Persona dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, religjioni ose kombi të caktuar, me qëllim që t'i përçmojnë të gjithë ata të cilët nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për gjenocid. Në raste të këtilla, liria e shprehjes interpretohet gjerë e gjatë dhe kalon në gjuhën e urrejtjes. Këto dukuri e aktualizuan diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie. “Në mediat tona dhe në gjendjen e tranzicionit dhe kulturës së ulët të fjalës dhe përdorimit të saj, nxitja dhe përhapja publike e urrejtjes së këtillë, pa ndjenjë të përgjegjësive për fjalën e thënë, paraqitet si gjenerator kryesor i klimës shoqërore dhe mostolerancës dhe paragjykimeve mbi baza nacionale, etnike dhe baza të tjera, e cila shfaqet në kuadrin e përgjithshëm psikologjik për ekspansionin e të gjitha formave të veprave të urrejtjes nga veprat e dhunës fizike deri tek veprat e dhunës verbale dhe psikike”. Ky punim shpresoj që sado pak ka dhënë informacione të reja , dhe mund të shërbej si një pikënisje e vogël në hapësirat juridiko-shkencore në lëmin e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë.⁶

⁶ Bashkim Dr. Selmani “E drejta e të drejtave të njeriut”, f. 35-59 Shkup, 2009.

5. Pozicioni i lirisë së shprehjes si standard themelor

Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes si standardë minimale rezultojnë nga aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Së pari, shtetet e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike, por gjithashtu, është me rëndësi të mundësohet edhe detyrimi pozitiv dhe shfrytëzimi papengesë i të drejtave të parashikuara të njeriut. Sipas kësaj, liria e shprehjes mund të gjendet në shumicën e kushtetutave si pjesë e të drejtave dhe lirive themelore.⁷ Kombet e Bashkuara Pas Luftës së Dytë Botërore, baza juridike për lirinë e shprehjes vendoset me aktet themelore të OKB-së, siç është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948, e cila konsiderohet si dokument themeltar juridik-ndërkombëtar për standardet e të drejtave të njeriut dhe vlen për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Ky akt ishte reagimi i parë juridik-ndërkombëtar në aspekt të asaj se çka i ndodhi botës pas dy luftërave botërore. Neni 1913 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut qartë përcakton se kush e ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes, me çrast kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e përfaqësimit të një mendimi të caktuar si dhe lirinë për të kërkuar, për të dhënë dhe marrë informacione dhe ide përmes mediave. Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948 thotë: Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.⁸ Sipas nenit 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, zbatimi i të drejtave dhe lirive është objekt i së drejtës nacionale. Sipas interpretimit juridik, kufizimet e të drejtave duhet të përcaktohen në mënyrë restriktive, ndërsa kjo do të thotë se e drejta kryesore nuk duhet të nënçmohet dhe kufizimi nuk guxon të jetë më i madh se nevoja e mbrojtjes së të drejtave dhe të mirave themelore publike. Njëkohësisht, qëndrimi i Kombeve të Bashkuara është se nuk mund të ketë liri pa përgjegjësi dhe se liria pa kufizime mund të shpie deri në shkeljen

⁷ Pozicioni i lirisë së shprehjes buron nga aktet juridike ndërkombëtare. Standar-10Shih: Rregullimi i mediave, studim komparativ, Dejvid Goldbert, Toni Proser dhe Stefan Berhulst, Ars Lamina, Shkup, 1998, f. 155-184; 11 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Stiven Grir, "Prosvetno delo", Shkup, f. xv 8.

⁸ Po aty.

e të drejtave të tjera të njeriut. Në vitin 1987 u themelua organizata , ndërkaq u regjistrua në Britaninë e Madhe, me qëllim që të bashkëpunojë me organizatat qeveritare ndërkombëtare, siç është Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe OSBE, si dhe me organizata joqeveritare ndërkombëtare. Misioni i Organizatës është realizimi i tri shtyllave të lirisë së shprehjes të përfshira në nenin 19 të Deklaratës Universale, edhe atë: 1. Liria e shprehjes si e drejtë për të folur, përkatësisht të tu shprehur mendimet politike, kulturore, sociale dhe ekonomike. E drejta e çdo individit të mos pajtohet me mendime të caktuara dhe ndërtim i demokracisë zgjedhore në të cilën ndërtohet besimi i publikut në administratë; 2. Liria e shprehjes si liri e shtypit (liria e mediave), përkatësisht e drejta e mediave të lira dhe të pavarura, pa frikë, ndërhyrje, diskriminim ose ndjekje në këtë fushë. Ndërtimi i sistemeve mediatike, të cilët do të sigurojnë dije, në të cilët do t'u jepet hapësirë, përkatësisht zë grupeve të marginalizuara dhe të theksohet ekzistimi i korrupsionit. Nga ky aspekt kjo do të krijonte mjedis në të cilin njerëzit do të ndiheshin të sigurt, në mënyrë participuese sa i përket qeverisë, që do të thotë qeveri e përgjegjshme dhe Liria e shprehjes si e drejtë për të ditur, ndërsa kjo do të thotë qasje në të gjitha mediat: internet, art, vepra akademike, informata qeveritare etj.

Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes

Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes shembull, e drejta e privatisë. Restriktionet duhet të elaborohen nga vendet duke u mbështetur në arsye juridike, të cilat mund të jenë temë e debatit publik dhe të miratohen nga institucionet gjyqësore me qëllim që më vonë të mund të procesohen. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është marrëveshje multilaterale e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, miratuar më 16 dhjetor 1966, ndërsa ka hyrë në fuqi më 13 mars të vitit 1976. Ai i obligon palët t'i respektojnë të drejtat civile dhe politike të njeriut, përfshirë edhe të drejtën e jetës, lirisë së religjionit, lirisë së shprehjes, lirisë së bashkimit, të drejtat e zgjedhjeve dhe të drejtën e gjykimit të drejtë. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga viti 1966 në nenin 19 e garanton lirinë e shprehjes. Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga viti 1966: *Askush nuk mund të jetë i shqetësuar për shkak të mendimeve të veta. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë, pavarësisht kufijve, e nënkupton lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informatave dhe ideve të të gjitha llojeve*

gojarisht, me shkrim, të shtypur ose në formë artistike, ose në çdo mënyrë tjetër të zgjedhur prej tij. Realizimi i lirive, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, i përshin detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta.

Rrjedhimisht me këtë, ai mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara të cilat duhet të përcaktohen në mënyrë eksplicite me ligj dhe të jenë të domosdoshme: a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë së shtetit, të rendit publik, të shëndetit dhe të moralit publik. Sipas nenit 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, liria e shprehjes i përfshin të gjitha fazat e identifikimit dhe diseminacionit të informatave, por edhe të ideve si informacione të përpunuara, pavarësisht formës ose medias në të cilën shfaqen.⁹ Ky lloj i lirisë së shprehjes u nënshtrohet detyrimeve dhe përgjegjësisë të cilat përcaktohen me legjislacionin nacional, por edhe me kodekset e etikës profesionale. Restriksionet e lirisë së shprehjes duhet të sigurohen me ligj, ndërkaq janë të domosdoshme: për respektimin e të drejtave dhe reputacionit të njerëzve të tjerë; për mbrojtjen e sigurisë nacionale ose rendit publik dhe për mbrojtjen e shëndetit ose moralit publik. Neni 19 është ngushtë i lidhur me nenin 20 të PNDKP, i cili e plotëson dhe në mënyrë plotësuese e kufizon shprehjen e cila propagandon luftë ose bën thirrje për urrejtje, diskriminim dhe dhunë. Formulimi i këtillë paraqet mbrojtje kualifikuese të lirisë së shprehjes, si dhe mbrojtje kundër formave më të rënda të keqpërdorimit të komunikimit të lirë. Neni 20 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike:

Çdo propagandë në favor të luftës do të ndalohej me ligj. Çdo thirrje për urrejtje nacionale, racore ose fetare, që paraqet nxitje të diskriminimit, armiqësisë 14 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, numër: 2200A(XXI), 16.12.1966, hyri në fuqi më 23.03.1976. Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes ose dhunës, ndalohet me ligj. Implementimin, e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga ana e shteteve anëtare, e monitoron Komiteti për të Drejtat e Njeriut, i cili është trup i përbërë nga ekspertë të parvarur. Shtetet anëtare janë të detyruara të paraqesin me rregull raporte pranë Komitetit për kualitetin e zbatimit të të drejtave të parashikuara me të. Pas shqyrtimit të çdo raporti, në formë të "vërejtjeve përfundimtare" rekomandimet e veta ua dërgon shteteve anëtare. Gjithashtu, Komiteti e publikon interpretimin e përmbajtjes së dispozitave për të

⁹ Bashkim Dr.Selmani, "E drejta e të drejtave të njeriut", f. 35-59, Shkup, 2009.

drejtat e njeriut, i njohur si komente të përgjithshme për çështje tematike ose për metoda të punës. Në vitin 1983 Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së miratoi koment të përgjithshëm në lidhje me nenin 19 të PNDKP. Më vonë, në vitin 1993, duke e pasur parasysh rolin e komunikimeve të reja dhe fuqinë e mediave, u emërua edhe Raportuesi Special i OKB-së për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe mendimit. Gjithashtu, si akt relevant i OKB-së është Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e vitit 1965 - neni 4 i Konventës kërkon nga shtetet anëtare ta përcaktojnë si vepër penale çdo përhapje të ideve që bazohen mbi superioritetit ose urrejtjen racore. Konventa ndalon nxitjen e diskriminimit etnik ose racor, urrejtjen dhe dhunën. Përveç këtyre akteve ndërkombëtare-juridike, të cilët janë relevant në nivel universal, ekzistojnë tre sisteme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ndërsa më specifike, liria e shprehjes, të sublimuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore neni X-të, Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve neni IX-të dhe Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut neni XII-të.

6. Liria e shprehjes në Republikën e Maqedonisë

Për Republikën e Maqedonisë relevante është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Këshillit të Evropës nga viti 1950, ku neni 10 e garanton të drejtën e lirisë së shprehjes. Duke e marr parasysh traditën e politikës evropiane në kultivimin e vlerave demokratike, mbrojtja e njëkohshme e identitetit nacional dhe kultivimit të dallimeve kulturore dhe pluralizmit, liria e shprehjes është një nga të drejtat qendrore të Konventës, e cila është edhe bazë e Politikës Evropiane për informim publik. Me këtë Konventë, përkatësisht në nenin e 10 të saj, i cili u bë sinonim i lirisë së mendimit dhe shprehjes së qëndrimit, mbrohet liria e mendimit, por përcaktohen edhe kushtet për kufizimin e saj. Përgjegjësinë për mbrojtjen e kësaj të drejte e kanë vendet të cilat janë nënshkruese të Konventës. Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore: Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i pengon shtetet që ndërmarrjeve të radiove, filmit dhe televizionit tu imponojë leje për punë. Kushtetuta e RM-së Një prej vlerave

themelore të Republikës së Maqedonisë është sundimi i së drejtës dhe ndarja e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 8). Koncepti i ndarjes së pushtetit është me rëndësi të veçantë për sigurimin e shtetit juridik, sepse respektimi i këtij koncepti duhet të sigurojë pavarësi dhe autonomi në punën e të gjitha organeve të pushtetit, në suazat e kompetencave të tyre, pa ndikime dhe presione midis tyre, jashtë nga marrëdhënie të cilat janë rregulluar me ligj. Në bazë të këtij parimi bazohet edhe pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit në shtetin tonë. Në Kushtetutën e RM-së (neni 98) është përcaktuar se gjykata e kryejnë pushtetin gjyqësor në mënyrë të pavarur dhe autonome dhe gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Nuk ekziston kufizim kohor në kryerjen e funksionit të gjykatësit. Themelimi, kompetenca, llojet, ndërprerja, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si edhe procedura para tyre përcaktohen me ligj i cili miratohet me dy të tretat e shumicë së votave në Kuvend. Këto ligje duhet të jenë në funksion të garancive institucionale për pavarësi dhe autonomi të sistemit gjyqësor. Në përputhje me Kushtetutën, funksioni i gjykatësit është inkompatibil me ushtrimin e ndonjë funksioni dhe profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në ndonjë parti politike. Ndalohet organizimi dhe veprimtaria politike në gjykatë. Në vitin 2005 kanë ndryshuar nenet kushtetuese të cilat lidhen me gjykatën, sidomos me procedurën e emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve, e cila nga Kuvendi i RM-së ka kaluar te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë. Shumica e anëtarëve të Këshillit (8 nga 15) i zgjedhin gjykatësit nga radhët e veta, por në punën e tij, sipas funksionit, merr pjesë edhe ministri i Drejtësisë. Anëtarësimi i tij nuk ka të drejtë vote, por megjithatë pjesëmarrja e tij nga opinioni perceptohet si përzierje e pushtetit ekzekutiv në atë gjyqësor. Realizimi i këtyre lirive, që përmbajnë detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj, të cilat në një shoqëri demokratike paraqesin masa të domosdoshme për sigurinë e shtetit, integritetin territorial dhe sigurinë publike, mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e trazirave dhe krimit, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit.¹⁰ Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtat e të tjerëve për pengimin e përhapjes së

¹⁰ <http://www.osce.org/fom> 18

<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/005.htm> 12.

informatave konfidenciale për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

7. Gjatë evaluimit se a është legjitim ose jo kufizimi i lirisë së shprehjes nga ana e shtetit

Gjatë evaluimit se a është legjitim ose jo kufizimi i lirisë së shprehjes nga ana e shtetit, gjykata këtë e përcakton edhe përmes kriterëve të parashikuara në nenin 10, paragrafin 2, të cilat doemos duhet të respektohen: 1. E parashikuar me ligj E parashikuar me ligj do të thotë se kufizimi i lirisë mund të ndodh vetëm mbi bazë të rregullit, paraprakisht të vendosur dhe të përcaktuar, por edhe mbi bazë të së drejtës zakonore, e cila është mjaftueshëm e qartë për individin, që të mund të supozojë se do të pasojë sanksioni për veprimin e tij. Me formulimin e këtillë “e parashikuar me ligj” përfshihen edhe sistemet juridike kontinentale me të drejtë të kodifikuara, por edhe me të drejtën precedente të sistemeve anglo-saksone. Qëllimi i këtij formulimi është të shmanget kufizimi eventual, i cili nuk është paraparë në sistemin juridik por është arbitrar dhe pa bazë ligjore. Gjithashtu, kuptimi i këtij kriteri është: “Së pari, ligji duhet të jetë i arritshëm-qytetari duhet të jetë i njoftuar, në mënyrë adekuate me rrethanat e akteve ligjore të cilat vlejnjë për një rast konkret. Së dyti, një akt i caktuar nuk mund të konsiderohet për ligj, nëse ai nuk është formuluar me saktësi të mjaftueshme në mënyrë që t’i mundësojë qytetarit harmonizimin e sjelljes së tij, nëse është e nevojshme këtë të mund ta bëjë edhe me këshillë përkatëse, të parashikojë se deri në cilën shkallë, e cila është e arsyeshme në rrethanat e dhëna, pasojat që mund të ndodhin si rezultat i ndonjë procedure të caktuar. Ato pasoja nuk duhet të parashikohen në mënyrë absolute, përvoja tregon se një gjë e tillë është e paarritshme.”

8. Kufizimi i lirisë së shprehjes

Kufizimi i lirisë së shprehjes, nëse parashikohet në ligj, mund t’i referohet shkaqeve të cekura në paragrafin 2 të nenit 10, e që janë: siguria e shtetit, integriteti territorial dhe siguria publike, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i trazirave dhe krimit, mbrojtja e shëndetit dhe moralit, dinjiteti dhe të drejtat e të tjerëve për pengimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Me rëndësi të veçantë është kualifikimi *e domosdoshme në një shoqëri demokratike*. Përmes këtij kriteri matet

nëse restriksioni ndaj lirisë së shprehjes paraqet masë të ndershme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike apo reagimi qeveritar është sanksion tepër i rreptë ndaj shprehjes së një mendimi konkret.¹¹ Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, statut tejet i rëndësishëm juridik, në kontekst të këtij testi, është margjina e respektimit ose diskrecionit e cila u lejon autoriteteve nacionale të përcaktojnë sipas vlerave nëse masat restriktive janë proporcionale. Megjithatë, kjo margjinë limitohet konform rasteve nëse me kufizimin parandalohet dhuna, sulmi apo kufizimi i shprehjes është tejet rigoroz. Kjo e lidh lirinë e shprehjes me konceptin e shoqërisë së hapur dhe pluraliste, e qeverisur sipas parimeve demokratike.

9. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e çmon lart vlerën e lirisë së shprehjes kundrejt interesave personale

Përkatësisht, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e çmon lart vlerën e lirisë së shprehjes kundrejt interesave personale për mbrojtjen e reputacionit të personave publik të përfshirë në procesin politik. Për realizimin e lirisë së shprehjes është i rëndësishëm edhe nenin 17, i cili e ndalon keqpërdorimin e të gjitha të drejtave nga Konventa, duke parashikuar se asnjë dispozitë e Konventës nuk do të interpretohet në mënyrë e cila implikon të drejtën e një shteti, grupi ose personi, të përfshihet në ndonjë nga aktivitetet ose të kryejë ndonjë akt me qëllim që të cenohet cilado qoftë e drejtë dhe liri, të përcaktuara me Konventë, ose limitimi i tyre në shtrirje më të madhe sesa parashikohet me Konventën. Në lidhje me kufizimin e lirisë së shprehjes, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e shfrytëzon edhe nenin 17 për parandalimin e grupeve totalitare që t'i keqpërdorin të drejtat e përcaktuara në Konventë. Në këtë drejtim, deklaratat të cilat bëjnë thirrje për dhunë ose urrejtje racore mund të përjashtohen nga gëzimi i lirisë së shprehjes edhe duke iu referuar nenit 17. Raste të këtilla mund të vërehen gjatë promovimit për të vendosur regjim totalitar, mohimit të Holokaustit, gjuhës së urrejtjes mbi bazë racore, si dhe thirrjeve për mostolerancë ndaj myslimanëve.

Përmes praktikës gjyqësore, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, arrihet deri në përkufizim më të qartë të shtrirjes së lirisë së shprehjes. “Liria e shprehjes aplikohet jo vetëm

¹¹ Sllagjana Dimishkova, faqe 18, “Liria e shprehjes dhe demokracia”, Veçer Press ShPK Shkup, Cetus print, 2008, Shkup 13.

për informata ose ide, të cilat pranohen pozitivisht ose konsiderohen si jo ofenduese apo indiferente, por edhe ato të cilat ofendojnë, tronditin ose e shqetësojnë shtetin ose cilindo sektor të popullatës”.¹² Vendimet e gjykatës rajonale për të drejtat e njeriut Deri në dhjetor, Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut *GjEDNj* ka shpallur shtatë vendime, me të cilat është konstatuar që shteti e ka shkelur Konventën evropiane për të drejtat e njeriut. Ndonëse në vitin 2009, qeveria e ka miratuar Ligjin për zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së, zyrtarët qeveritarë nuk e kanë zbatuar atë në mënyrë adekuate dhe qeveria ka përmbushur vetëm disa prej urdhrave të GjEDNj-së në kohë dhe mënyrë adekuate. Procedurat gjyqësore civile dhe mjetet juridike Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblimi ose ndërprerja e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Individët mund të ngrenë procedura për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga kryerësi i shkeljes së pretenduar. Individët mund të parashirojnë edhe ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit në kohë, si dhe bazën ligjore për ngritjen e procedurave kundër vonesave të tepërta, para Gjykatës supreme. Individët mund të ankohen te GJEDNJ ndaj aktgjykimeve për shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut nga ana e shtetit.

10. Liria e fjalës dhe shtypit nga praktika e Maqedonisë

Gjendja e lirisë së fjalës dhe shtypit Kushtetuta e parasheh lirinë e fjalës dhe shtypit. Megjithatë, qeveria nuk ka treguar në të gjitha rastet respekt për këto të drejta në praktikë, ndërsa presioni qeveritar mbi mediat ka qenë problem në rritje. Liria e fjalës: Ligji i ndalon fjalimet të cilat nxisin urrejtje nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh sanksione për personat që i shkelin këto ligje. Individët kanë pasur mundësi ta kritikojnë qeverinë publikisht ose privatisht, por ka pasur raporte sipas të cilave qeveria ka tentuar ta pengojë kritikën. Nga hulumtimet dhe vrojtimit e deritashme konstatohet se politika e realizon fuqinë e saj institucionale nëpërmjet shtetit, sepse lufta politike midis partive, para së gjithash, është e orientuar kah shteti, si objektivi i fundit i tyre. Shteti paraqet interesin themelor politik të çdo

¹² Rasti *Handyside* kundër Mbretërisë së Bashkuar.

partie politike, sepse secila parti ka të drejtën e organizimit të masave të ligjshme detyruese. Në këtë kuptim, në nivel të shtetit hartohet dhe miratohet politika e sigurisë, e cila shërben si kornizë themelore për realizimin e interesave fundamentale të shoqërisë. Nuk ka dyshim se politika e sigurisë ka një vend specifik, me që ajo është një prej levave më të rëndësishme të sigurisë, e cila krijon parakushtet e nevojshme për zhvillim progresiv të shoqërisë në të gjitha fushat e jetës. Kështu, më nuk mund të vihet në pyetje rëndësia e shkencës së sigurisë, e cila është faktor i rëndësishëm në hartimin e politikës së sigurisë dhe strategjisë së zbatimit të saj. Pra, në rrafshin teorik dhe shkencor e profesional, me një qasje sistemore dhe interdisiplinare komplekse krijohet mundësia për shqyrtimin e të gjitha premisave relevante edhe në bazë të vrojtimeve të tyre themelore, vendosen dhe ndriçohen problemet që mund të shkaktojnë ose shkaktojnë pasoja komplekse për sigurinë. Çdo shkencë, pra edhe shkencës mbi sigurinë, mbi të gjitha, i intereson e kaluara dhe e tashmja, e cila shërben si substrat për miratimin e planeve operative që duhet të shërbejnë për eliminimin ose uljen e rreziqeve për sigurinë në fusha të ndryshme. Arsyet e përmendura më sipër të progresit shkencor-teknik pa dyshim kërkojnë hulumtime inter-disiplinare dhe nevojën e reciprocitetit, në mënyrë që problematikës së sigurisë t'i qasemi si një faktori relevant dhe dinamik me politikë të sigurisë të definuara qartë. Mbështetja e fortë profesionale e operative mundëson krijimin e strategjisë reale të zbatueshme për të arritur objektivat e përcaktuara.¹³ Me këtë rast, duket të thuhet se objektivat e sigurisë duhet të të krijohen ashtu që nëpërmjet strategjisë së përcaktuar qartë e në bazë të njohurive shkencore e profesionale të formësohet politika e sigurisë. Për këtë arsye është joreale të pritët që ajo të jetë e përshtatshme në qoftë se nuk është harmonizuar në pajtim me objektivat më të rëndësishme dhe me interesat primare të shoqërisë bashkëkohore. Vetëm në këtë mënyrë mund të përmbushen kërkesat e sigurisë dhe të jepet kontribut në zhvillimin, harmonizimin dhe orientimin e interesave vitale të

¹³ Objektivat e përmendura, pra eliminimi i rreziqeve të sigurisë në fusha të ndryshme, mund të arrihen vetëm me një strategji të menduar mirë. Por, fushat e veprimit të mekanizmave të sigurisë nuk mund të mbështeten vetëm në aparatit shtetëror, por duhet të mbështeten edhe në komponentat tjera të shoqërisë civile. Mu për shkak të diskontinuitetit të madh në zhvillimin e teknologjisë, të vatrave të ndryshme të pasigurisë dhe organizimit të pamjaftueshëm institucional, shtrohet nevoja e konstituiutiv të hapësirës që duhet të krijojë mundësi për përfshirjen e të gjitha subjekteve.

shoqërisë. Këtu qëndron rëndësia e saj politike dhe e sigurisë, në mënyrë që në bazë të mendimit shkencor e profesional dhe të përvojës paraprake të eliminohen të gjitha pengesat që shpiten te jofunksionaliteti i rendit juridik. Për të mos ardhur deri të kriza në funksionimin e rendit juridik dhe për të operacionalizuar me sukses politikën e sigurisë, është e nevojshme të hartohet strategjia.

Fjala strategji rrjedh nga fjalët greke *stratos-ushtri* dhe *agoudhëheq*. Ky nocion është përvetësuar dhe është shfrytëzuar në të gjitha hapësirat gjuhësore. Ai përdoret që prej vitit 500 para erës së re. Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe përdorimin e këtij nocioni ka dhënë Sun Cu Yu, i cili e ka shkruar veprën e njohur nga sfera e shkathtësive ushtarake. Më vonë, ai është përpunuar në mënyrë përmbytjesore nga gjenerali K.U. Clauzeuitz, i cili ka shprehur qëndrimin e tij tashmë të njohur se “lufta nuk është asgjë tjetër veçse vazhdim i politikës me mjete të tjera”. Ai nuk e ka renditur strategjinë as në mesin e dijes as në mesin e shkathtësive. Por, pikëpamja e tij shpreh qartë ndikimin vendimtar të politikës në strategjinë. Edhe shumë autorë të tjerë kanë dhënë definicionet e tyre. Në të gjitha pikëpamjet e tyre qëndron konstatimi se strategjia është syri i shkathtësisë. Këtu ata kanë përmendur edhe taktikën operative, por rol dominues i kanë dhënë strategjisë. Strategjia e përcakton zgjedhjen e metodave dhe mjeteve për realizimin e objektivave të politikës së sigurisë që kanë një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.¹⁴

Një analizë e shkurtër e njohurive të deritashme çon te konstatimi se ende nuk ka një përpunim përkatës teorik e shkencor dhe profesional e operativ për përpunimin e strategjisë së sigurisë, e cila do të mundësonte planifikimin real të të gjitha masave operative, taktike, teknike e të tjera, me qëllim të përballimit dhe zgjidhjes së problemeve të sigurisë në shoqëri, duke respektuar të gjitha elementet e politikës së sigurisë. Për këtë arsye, rëndësi themelore ka kuptimi shkencor e profesional i esencës dhe i përmbytjes së strategjisë, në bazë të të cilave mund të hartohen plane reale, nëpërmjet operacionalizimit të të cilave arrihet

¹⁴ Në fushën e sigurisë së shtetit pashmangshëm shfaqen një sërë interesash e konfliktesh (politike, ekonomike, sociale etj.). Ato shoqërohen me devijime në fusha të ndryshme të jetës e të punës dhe manifestohen me një sërë dukurish që çojnë drejt destabilizimit të nënsistemeve të caktuara. Kjo tregon se strategjia e sigurisë, para së gjithash, duhet të trajtohet nga këndvështrime interdisiplinare. Detyrë themelore e të cilës është që, në bazë të njohurive shkencore dhe praktikës, të gjendet zgjidhje për të gjitha problemet e sigurisë dhe të gjenden zgjidhje e metodave dhe mjeteve adekuate.

dhe ruhet gjendje e mirë e sigurisë. Së këndejmi, para teorisë së sigurisë shtrohen kërkesa të larta shkencore e profesionale interdisiplinare. Në qoftë se dëshirojmë që strategjinë ta bazojmë në njohuritë shkencore, profesionale e operative, duhet të dimë se është shumë vështirë të perceptohet realiteti në sferën e sigurisë, për shkak të formave më të ndryshme të rrezikimi, të cilat është e pamundur të studiohen deri në fund. Prandaj, kurrë nuk mund të flitet për siguri absolute të shoqërisë. Pikërisht për shkak se nga aspekti teorik e metodologjik ky proces është shumë i ndjeshëm dhe i rëndë, në krahasim me fushat tjera me faktorë të shumtë specifike që ndikojnë në situatën e sigurisë. Prandaj, strategjia e sigurisë duhet të jetë e drejtë dhe e pranueshme për shoqërinë, e orientuar ndaj objektivave që duhet t'i arrijë, të cilat burojnë nga politika e sigurisë. Por, gjatë operacionalizimit të strategjisë së sigurisë, gjithmonë shfaqen sfida që do të pengojnë realizimin e objektivave të përcaktuara.¹⁵

Në kushte pluraliste specifike, qytetarët mund të japin ndihmë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve kryesore të sigurisë. Komplementariteti dhe multidisiplinariteti i strategjisë së sigurisë shprehet në llojllojshmërinë dhe lidhshmërinë dialektike me një sërë nënsistemesh, të cilat kanë funksione të ndryshme. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i strategjisë së sigurisë në kuptimin dhe përmbajtjen e plotë të saj domosdo shtron nevojën e bashkëpunimit midis subjekteve të ndryshme. Veprimi i përbashkët i një sërë asociacionesh dhe institucionesh mund të jetë shumë i frytshëm në ruajtjen e segmenteve relevante të sigurisë. Në pajtim me objektivat e planifikuara, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet dhe aktivitetet për kundërvënien me sukses ndaj kundërshtive që mund të shndërrohen në vatra të sjelljeve të ndryshme devijuese. Vetëm një strategji efikase, e orientuar mirë, legjitime, praktike, me metoda e mjete të ligjshme, e përcaktuar në aspektin kohor e hapësinor, e bazuar në njohuritë shkencore e profesionale dhe në përvoja të nivelit shtetëror mund të operacionalizohen me sukses objektivat

¹⁵ Pa zgjidhje të tilla nuk mund të merren vendime konsistente mbi përcaktimin e orientimeve operative e të tjera, me qëllim të krijimit të kornizës së dëshiruar të sigurisë në një shtet. Çdo strategji duhet të mbështetet në njohuritë dhe forcën e operacionalizimit të saj, ashtu që organet dhe shërbimet e sigurisë të kenë të drejtë legjitime për përdorimin e dhunës, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin. Strategjia globale në nivel të shtetit vështrohet si strategji nacionale, prandaj gjithnjë e më shumë përdoret nocioni "strategji e sigurisë nacionale", e cila duhet të mbulojë të gjitha fushat e veprimit, me një sërë nënstrategjish që kanë të bëjnë me segmente të veçanta të punës së subjekteve të sistemit të sigurisë.

e politikës së sigurisë. Strategjinë e veprimit e hartojnë bashkërisht të gjitha organet dhe institucionet e një shteti, të cilat kanë funksione të ndryshme në fusha të ndryshme.¹⁶

Conclusion

It needs to be expanded the scope of the study by the special institutes which should be established in the Republic of Macedonia, regarding the position of human rights, the family, the real situation and the challenges in contemporary society in advancing human rights, seen in the prism of the Human Rights in the field of the right to free thinking and the right of expression. So these are the degrees of divergence and convergence that exists between legal rights and citizens' opinions regarding practical implementation, that how many citizens feel these laws, by analyzing and studying the comparison of rights in relation, for the pronouncement of citizens' opinions regarding the right of free thinking and the right of expression in the Republic of Macedonia. Based on what we have said above, we can conclude that this is just one of the introductory descriptions of human rights in the domain of the right of free thinking and the right of expression in the Republic of Macedonia.

Albanian society is interested for seeking alternative opportunities that processes be developed into positive connotations, but in practice does not reflect even by the other side, which constantly traces the sense of undemocratic and non-civilizational actions. The changes that may be made in relation to preventive policy and comparative views between relevant international legislation in the protection of values and human dignity should be the main oath of a particular state which claims to be democratic and open to European and international values. Also, the state of Macedonia should also respect international conventions in parallel with universal values where it is itself a signatory of these international documents. International legal acts in force exactly the European Convention on Human Rights. Characteristics and other auxiliary scientific views on human rights such as those; social, economic, cultural, civil, political, etc.

¹⁶ Pavarësisht prej rëndësisë së tyre të ndryshme, secili prej nënsistemeve është në funksion të ruajtjes së gjendjes së sigurisë, gjë që mundëson zhvillimin e papenguar të shoqërisë bashkëkohore. Orientimi strategjik e metodologjik, sidomos në situata komplekse, është parakusht thelbësor për realizimin e detyrave.

Seeing as a problem closely related to the development of legal science and human rights. So concrete rhetorical approaches and their operationalization, as well as the definition of specific global objectives and priorities, paying attention efficient operation of all elements of the security system and their adaptation with the various challenges that emerge from the outer environment. This is the task of security strategy. It sets out the orientations, methods, tools, time, space, conditions, and action options that depend on the complexity of the security problem. The plurality of subsystems that act in accordance with their position in the organizational structure, which have rights, tasks and clearly defined obligations, requires a precise planning of their concrete tasks.

BILBLIOGRAFIA

1. Abrams, Philip 1982, Historical Sociology (Ithaca, NY: Cornell University Press)
2. Adorno Theodor, Negativna dijalektika, BIGZ, Beograd, 1979
3. Adorno Theodor, The stars down to earth, Los Angeles Times astrology column, Telos, 19, 1974
4. Adorno Theodor, The Authoritarian Personality, New York, 1950
5. Adorno, M. Horkheimer, Socioloske studije, Skolska knjiga, Zagreb, 1936
6. Alen V.L., The Sociology of Industrial Relations, Longman, London, 1971
7. Althusser L., Ideology und Ideological State Apparatuses in Cosin, 1972
8. Bashkim Dr. Selmani "E drejta e të drejtave të njeriut" - Universiteti parë privat "FON"-Shkup, 2012.
9. Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi "Sistemet e sigurisë-Sistema Security"-Shkup, 2016.
10. Bart Frederick, Ethnic Groups and Boundaries, London, 1969
11. Bell Daniel, Crime as an American way of Life, Antioch Review, 13 Bastide Roger, Sociologija i psikoanaliza, Naprijed, Zagreb, 1978
12. Bakić Ibralić, Nacija i religija, Bosna Publik, Sarajevo, 1994
13. Bober Juraj, Stroj, covjek, drustvo, Naprijed, Zagreb, 1970
14. Bell Daniel, The Coming of Post-Industrial Society, Heinemann, London, 1973.
15. Bequai A., Organized Crime, 1980 Blumberg Paul, Industrial Democracy, London 1960

16. Dockes Pierre, Internacionala kapitala, Skolska knjiga, Zagreb, 1977
17. Dolman AJ. i I. van Ettinger, Partneri u sutrasnjici, Globus, Zagreb, 1979

